

# Komunikatë për shtyp

## SEANCË PUBLIKE E ZYRËS SË RREGULLATORIT PËR ENERGJI

PRISHTINË, 06 DHJETOR, 2005: Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë do të mbajë Seancë Publike në ndërtesën e KEK-ut (Toskanë, dhoma e konferencave, kati përdhës), më 15 Dhjetor 2005. Qëllimi i kësaj seance është miratimi i katër rregullave që kërkohen sipas Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë.

Këto rregulla vendosin funksionin e ZRRE-së, metodologjinë dhe procesin për përcaktimin e tarifave.

Rregullat që do të miratohen në këtë seancën publike janë:

**1. Statuti i ZRRE-së** i cili përcakton strukturën e brendshme të procesit vendimmarrës në ZRRE. Rregulla e propozuar siguron që të gjitha seancat vendimmarrëse të Bordit duhet të jenë të hapura për publikun përveç në rastet kur ka bëj me informata konfidenciale (të besueshme).

**2. Kodi i sjelljes dhe Etikës** themelon parimet etike dhe rregullat e sjelljes që qeverisin anëtarët e stafit të ZRRE-së (duke përfshirë edhe anëtarët e Bordit). Ky kod, ofron udhëzime mbështetëse dhe përgjegjësi ligjore si dhe mënyra se si të mënjanoen konfliktet aktuale të interesit ose ato që do të shfaqen në të ardhmen, si dhe përshkruan përgjegjësitë në lidhje me fshehtësinë e informatave, marrëdhëniet me konsumatorët, donatorët, investitorët, mediat.

**3. Metodologjia e Tarifave të Energjisë Elektrike** përshkruan mënyrën se si mbulohen të hyrat e lejuara të ndërmarrjeve me tarifave të rregulluara që do të përcaktohen nga ZRRE-ja dhe vendos parimet që do të udhëzojnë ndërmarrjet e energjisë në përgatitjen e propozimeve të tarifave. Objektivat e Metodologjisë së Tarifave janë:

- **Realizueshmëri Financiare** – Tarifave duhet të mundësojnë mbulim të plotë të kostos nëse duhet të bëhet ndonjë investim
- **Efikasitet** – Tarifave duhet të nxisin uljen e shpenzimeve dhe duhet të reflektojnë koston
- **Pranueshmëria** – Tarifave duhet të jenë të mundshme për t'u paguar, dhe rritja e tyre duhet të ndërlidhet me përmirësimet në kualitetin e shërbimeve

**4. Rregulla e Çmimeve** përcakton parimet për përlllogaritjen dhe aprovimin e tarifave të rregulluara në sektorin e energjisë elektrike në Kosovë dhe procedurat për dorëzimin, shqyrtimin, modifikimin, aprovimin dhe mbikëqyrjen e tarifave të rregulluara nga ndërmarrjet e energjisë.

Qëllimet e këtyre Rregullave janë që të sigurojnë:

- a) Funksionim transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë, bazuar në parimet e tregut të lirë;
- b) Përbushje të aktiviteteve të energjisë të cilat ju nënshtrohen obligimeve të shërbimeve publike në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese;
- c) Çmimet për aktivitetet e energjisë të cilat janë të rregulluara janë të arsyeshme dhe fikse në bazë të metodologjisë së tarifave;
- d) Që interesat në mes të konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë janë në mënyrë adekuate të balancuara;
- e) Zbatimin e masave të përshtatshme për të forcuar kohezionin social dhe ekonomik nëpër Kosovë;
- f) Sigurinë e furnizimit me energji elektrike përmes mirëmbajtjes dhe ndërtimit të gjenerimit të nevojshëm dhe kapacitetit transmetues, si dhe infrastrukturës së rrjetit, përfshirë kapacitetin ndërlidhës;
- g) Mbrojtjen e konsumatorëve përmes promovimit të qasjes transparente dhe të hapur në informacion, në lidhje me çmim-vënien dhe tarifën.

**Gjatë zhvillimit të rregullave të propozuara, ZRRE-ja ka postuar rregullat në faqen e vet elektronike dhe ka mbajtur dëgjime publike për të 4 rregullat, në mënyrë që të merrte dhe shqyrtonte komentet. Gjatë sesionit publik do të sigurohet një mundësi për komente të mëtejme publike.**

**Kopjet e rregullave të propozuara dhe programi i mbledhjes janë të postuara në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së: [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org)**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë është një Autoritet i Pavarur Rregullativ sipas seksionit 11.2 të kornizës kushtetuese, i themeluar më 30 qershor 2004 sipas Ligjit 2004/9 dhe Rregullores 2004/20.

ZRRE-ja është krijuar për të siguruar një furnizim të besueshëm, të sigurtë dhe të shëndetshëm nga aspekti ambiental për konsumatorët e Kosovës, si dhe të promovojë, krijojë dhe mbrojë tregun konkurrues të energjisë, bazuar mbi parimet e objektivitetit, transparencës dhe jo-diskriminimit.